REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVIZIONIT PËR VITIN 2009

Kuvendi i Shqipërisë, në përputhje me nenin 103 të Rregullores së Kuvendit dhe me ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, pasi u njoh me raportin vjetor të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit për vitin 2009, vëren se:

- Veprimtaria e KKRT-së është ushtruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
- KKRT-ja ka arritje të dukshme në zbatimin e kërkesave të Kuvendit të Shqipërisë.

Kuvendi vlerëson se:

- KKRT-ja gjatë vitit 2009 ka bërë përpjekje maksimale për të rritur efiçencën e punës së saj, duke kontribuar në ngritjen e cilësisë së shërbimit të radios dhe televizionit dhe në mbrojtjen e interesave të operatorëve dhe konsumatorëve.
- KKRT-ja ka ushtruar kontrolle të vazhdueshme dhe ka vendosur sanksione ndaj shkelësve të ligjit, duke rritur në këtë mënyrë garancitë për një konkurrencë të ndershme.
- KKRT-ja ka hartuar projektstrategjinë e kalimit nga sistemi analog në atë numerik.

Kuvendi kërkon nga KKRT-ja:

- Marrjen e masave për kalimin sa më shpejt në transmetimet numerike brenda afatit të përcaktuar nga Qeveria.
- Rritjen e efikasitetit ndaj luftës kundër piraterisë televizive.
- Zbatimin me rigorozitet të ligjit ndaj operatorëve që transmetojnë programe të propagandës së diktaturës komuniste.
- Zbatimin e etikës në transmetimet televizive, respektimin e barazisë gjinore dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.
- Realizimin e shpenzimeve të planifikuara.
- Të ushtrojë ndikimin e saj tek operatorët radiotelevizivë për realizimin e programeve të veçanta për emigrantët, sidomos për mësimin e gjuhës shqipe dhe promovimin e trashëgimisë historiko-kulturore .
- Të marrë pjesë aktive në diskutimin e projektligjit të ri "Për transmetimet me zë dhe figurë në Republikën e Shqipërisë".

Kuvendi nxit:

- Bashkëpunimin e efektshëm të organeve të tjera shtetërore, si Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit, për të siguruar zbatimin e ligjit.

29 prill 2010